

Përparësi për t'u përmbushur deri në Konferencën e Parë Ndërqeveritare

Nr.	Prioriteti	Masat	Hapat	Institucionet e Përfshira	Afatet
1	Miratimi i reformës zgjedhore	1. Miratimi i reformës zgjedhore (përfshirë financimin e fushatave elektorale) 2. Miratimi i ligjit të posacëm për financimin e partive politike	1. Marrja e Opinionit ODHIR mbi draftet e propozuara 2. Votimi në Parlament i Reformës Zgjedhore, duke përfshirë çështjen e financimit të fushatave elektorale 3. Hartimi, konsultimi me partnerët (NDI dhe OSBE) 4. Miratimi në Parlament i ligjit të posacëm për financimin e partive politike	Kuvendi (Këshilli Politik)	Miratimi i reformës zgjedhore: Korrik 2020 Miratimi i Ligjit të Posacëm për financimin e partive politike: Tetor 2020
2	Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese	Plotësimi fillimisht i Gjykatës Kushtetuese me 6 anëtarë minimalisht:	1. KED duhet të përfundojë procesin e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për tre vendet vakante (korrik 2020) 2. Procedurat për t'u përshpejtuar elektronikisht (Mbledhje e KED per t'u mbajtur online asap) 2. Institucionet e tjera të cilat japin informacion mbi integritetin e figurave për KED, duhet të përshpejtojnë procedurat e informimit 3. Pas verifikimit të dosjeve KED duhet t'i dërgojë Kuvendit dhe Presidentit listën përfundimtare për votim 4. Ri-shpallje (me shumë propabilitet) e vendeve vakante nga KED-Shtator 2020 -nëse ka probleme komfirmimet nga KPK dhe KPA	Këshilli I Emërimeve në Drejtësi (KED); Presidenti I Republikës; Parlamenti; Këshilli i Lartë i Gjyqesor	Opinionimi Komisionit të Venecias për emërimin e anëtarëve të GjK: Qershor 2020 KED pritet të përfundojë procesin plotësimi të 3 vendeve të

Commented [U1]: Të ndërtohet një proces i mirëstrukturuar, transparent dhe gjithëpërfshirës.
Të përcaktohet qartë se cili institucion do të marrë përsipër udhëheqjen e hartimit, koordinimit, konsultimit, miratimit, dhe më pas të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit për 15 kushtet e përcaktuara.
Duhet të këtë një kalendar të qartë të këtij procesi që kërkon angazhim më të gjerë se përgjegjësitë e ekzekutivit, gjithmonë në rast se ky proces do të jetë gjithëpërfshirës, e si rrjedhojë me bashkëpërgjegjësinë përkatëse të gjithsecilit.
Plani i veprimit duhet t'i qëndrojë plotësisht besnik 15 kushteve, siç janë përcaktuar nga Bashkimi European

Commented [U2]: Prioriteti të përfshihet i plotë, duke i qëndruar besnik konkluzioneve të Këshillit European të 25 marsit 2020.
Të miratojë reformën zgjedhore, plotësisht në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR, duke siguruar transparencën e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore

Commented [U3]: Prioriteti 2 i BE thotë **“Të sigurojë vazhdimësinë e zbatimit të reformës në drejtësi,** përfshirë sigurimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën ndërkombëtare përkatëse përfshirë opinionet e Komisionit të Venecias”

Sigurimi i vazhdimësisë së zbatimit të reformës në drejtësi duhet të përfshihet si prioritet i veçantë

Commented [U4]:
Masat:
1.Ndjekja e procedurave kushtetuese dhe ligjore për plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese
Hapat:

			5. Marrja e Opinionit të Komisionit të Venecies për statusin e një anëtareje (qershor 2020)		lira të punës: Korrik 2020 Plotësimi GjK me 6 anëtarë pritet: Tetor 2020	<p>Commented [U5]: Masat duhet të përfshijnë plotësimin e Gjykatës së Lartë me të gjithë trupën gjyqësore brenda shtatorit 2020.</p> <p>Hapat duhet të përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Ndjekja e procedurës administrative të dorëzimit të detyrës sipas ligjit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, nga rradhët e jo-gjyqtarëve; 2.Përfundimi brenda muajit qershor 2020 i procedurave për kualifikimin, pikëzimin dhe përzgjedhjen e anëtarit të katërt dhe të fundit jo-gjyqtar nga KLGJ; 3.Betimi përpara Presidentit të Republikës dhe fillimi i ushtrimit të detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë; 4.Përfundimi brenda muajit korrik 2020 i procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit të kandidatëve që kanë aplikuar për në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për 6 (gjashtë) pozicionet e shpallura në shkurt 2020 dhe propozimi për emërim i kandidatëve të përzgjedhura; 5.Betimi përpara Presidentit të Republikës dhe fillimi i ushtrimit të detyrës së 6 anëtarëve të rinj të Gjykatës së Lartë; 6.Shpallja menjëherë e thirrjes për aplikim për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për 8 (tetë) vendet vakante në Gjykatën e Lartë për t'u plotësuar nga rradhët e Gjyqësorit; 7.Investimi i të gjitha burimeve për verifikimin, kualifikimin, pikëzimin, dhe propozimi për emërim të kandidatëve; 8.Betimi përpara Presidentit të Republikës dhe fillimi i ushtrimit të detyrës së 8 anëtarëve të Gjykatës së Lartë; 9.Marrja e masave proporcionale për dosjet e mbartura në Gjykatën e Lartë, për shqyrtimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm; 10.Shpallja nga Gjykata e Lartë, e thirrjes për aplikim për plotësimin e tre vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese që i përkasin për emërim Gjykatës së Lartë si organ emërtese.
3	Funksionimi i Gjykatës së Lartë	Përfundimi i procedurave të përzgjedhjes nga Këshilli i Emërimeve dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përzgjedhja e 1 gjyqtari të Gjykatës së Lartë nga rradhët e juristëve të spikatur, jo-gjyqtar. <ul style="list-style-type: none"> - Përfundimi i procedurave të kualifikimit para KLGJ për anëtarin e katërt - Betimi para Presidentit (brenda 10 ditëve). 2. Fillimi I procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të GJL nga rradhët e gjyqësorit <ul style="list-style-type: none"> - KLGJ të ri-shpallë hapjen e thirrjes (pas pezullimit të thirrjes së 26 shkurtit), verifikimet, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për 6 vendet e shpallura. Të gjithë anëtarët duhet të kenë kaluar vetting. - Të miratojë listën me renditjet - Betimi para Presidentit 	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED); Presidenti i Republikës; Kuvendi; Këshilli i Lartë i Gjyqësorit	Plotësimi fillestar i Gjykatës së Lartë me një minimum prej 6 anëtarësh për të lejuar një varg të kufizuar të procedurave dhe vendimmarrjes Tetor 2020 Plotësimi i Gjykatës së Lartë me 10 anëtarë, për të kryer të	

					<p>gjitha llojet e gjykimeve me përjashtim të atyre nga Kolegjet e Bashkuara:</p> <p>fund i vitit 2020</p> <p>Plotësimi i plotë i Gjykatës së Lartë me 12 anëtarë (shumica e kërkuar për të votuar Gjykatën Kushtetuese)</p> <p>Tremujori i parë i 2021</p>
4	Finalizimi i ngritjes së strukturave kundër krimit të organizuar dhe anti-korrupsionit/ Funksionimi i SPAK	Plotësimi i SPAK me 15 prokurorë	<p>1. Plotësimi i SPAK me 15 anëtarë (verifikimi, pikëzimi dhe renditja nga KED. Betimi)</p> <p>2. Përzgjedhja e Byrosë Kombëtare të Hetimeve (BKH)</p> <p>3. Arritja e një rekordi pozitiv ndëshkueshmërie</p>	Keshilli i Lartë i Prokurorise	<p>Tashmë, SPAK ka filluar hetimet kundër zyrtarëve të lartë / Operative</p> <p>Plotësimi me 15</p>

Commented [U6]: Prioriteti 4: Të përfundojë ngritja e strukturave të posaçme kundër krimit të organizuar dhe anti-korrupsion (SPAK dhe BKH).

Masat:

1. Plotësimi i SPAK me 3 anëtarë (12/15 kanë nisur detyrën);
2. Ngritja dhe nisja e funksionimit të BKH.

Hapat:

1. Verifikimi, pikëzim dhe renditja e kandidatëve për 3 vende vakante;
2. Betimi i anëtarëve të rinj përpara Presidentit të Republikës dhe fillimi i ushtrimit të detyrës.

Institucionet e Përfshira: KLP, SPAK, President.

5	<p>Forcimi I luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bashkëpunim me vendet anëtare dhe nëpërmjet Plan Veprimit për adresimin e krimit financiar</p>	<p>1. Zbatimi i Ligjit Normativ të datës 30.01.2020 për masat parandaluese për forcimin e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimin e rendit publik</p> <p>2. Zbatimi i planit të veprimit 2019-2020, në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit të Paligjshëm dhe Terrorizmit, miratuar me VKM Nr. 616, datë 18.09.2019</p> <p>3. Analizë mbi kërcënimet dhe dobësitë e PP-së për sektorët/produktet specifik, me theks të veçantë në pasuritë e paluajtshme, agjentët e pasurive të paluajtshme, avokatët, kontabilistët, dhe keqpërdorimin e llojeve të ndryshme të personave juridik (Pika 1.1 e 'Immediate Outcome 1' të Rekomandimeve të FATF)</p> <p>4. Realizimi i një plani unik të koordinuar për mangësitë që kanë rezultuar nga Vlerësimi kombëtar i riskut për PP/FT dhe çfarë do të rezultojë nga analizat e mësipërme (Pika 1.2 e 'Immediate Outcome 1' të Rekomandimeve të FATF)</p> <p>5. "Projekti Fiskalizimit" për trajtimin e ekonomisë joformale dhe</p>	<p>1. Vazhdimi i Forcës Operative të Ligjit (OFL), duke rritur numrin e hetimeve proaktive ndaj grupeve kriminale dhe individëve me prejardhje të dyshimtë kriminale.</p> <p>2. Forcimi i kapaciteteve hetimore të Policisë së Shtetit duke krijuar tre njësi speciale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit: a) njësinë e hetimit të krimit ekonomik b) njësinë e inteligjencës (menaxhimin e informacionit) c) njësinë e krimit kibernetik</p> <p>3. Analiza e produkteve dhe shërbimeve bankare dhe rreziku që ata paraqesin në sistemin tonë bankar në drejtim të pastrimit të parave;</p> <p>4. Analiza e keqpërdorimit të llojeve të ndryshme të personave juridikë për pastrim parash;</p> <p>5. Analiza e rrezikut në lidhje me pasuritë e patundshme dhe agjentët e pasurive të paluajtshme në fushën e pastrimit të parave;</p> <p>6. Analiza e rrezikut të kontabilistëve në fushën e pastrimit të parave;</p> <p>7. Analiza e rrezikut të avokatëve në fushën e pastrimit të parave;</p> <p>8. Identifikimi i pikave të dobëta si rezultat i vlerësimit kombëtar të rrezikut, masave të propozuara për zbutjen e tyre dhe institucioneve përgjegjëse;</p> <p>9. Zbatimi nga GTD i modulit: "Implementimi i faturave me para në dorë për bizneset me qarkullim mbi 8 milion lekë</p> <p>10. Trajnimi i stafit për përdorimin e sistemit elektronik.</p>	Qeveria	<p>Analiza e rrezikut në lidhje me produktet dhe shërbimet bankare plus Analizën e keqpërdorimit të llojeve të ndryshme të personave juridikë për pastrim parash që pritet të përfundojnë nga:</p> <p>Qershor 2020</p> <p>Analizat e rrezikut në lidhje me: pasuritë e patundshme dhe agjentët e pasurive të patundshme, llogaritarët dhe avokatët në fushën e pastrimit të parave:</p>
---	--	--	--	---------	---

Commented [U7]: Prioriteti 5: Të forcojë më shumë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë përmes bashkëpunimit me vendet anëtare të BE dhe përmes plan-veprimit në përgjigje të rekomandimeve të FATF (Financial Action Task Force).

Masat: Të përfshihen masat që lidhen me veprimtarinë e SPAK, BKH, Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe gjurmimi i rezultateve lidhur me to.

Të rishikohet pika 1 e masave, në dritën e faktit se Akti Normativ i datës 30.1.2020 dhe çdo nismë ligjore e lidhur me të janë masa që shkelin kompetencat kushtetuese të organeve të reja të drejtësisë, siç është ngritur me shqetësim nga Presidenti i Republikës dhe organizatat e shoqërisë civile.

Gjithashtu të përfshihen si pika të veçanta secili prej rekomandimeve të FATF, duke zbrëthyer hapat konkrete për realizimin e tyre, bashkë me institucionet përgjegjëse.

		<p>zvogëlimin e përdorimit të parasë fizike</p> <p>6.Vënia në funksionim të një sistemi elektronik brenda Ministrisë së Drejtësisë për prioritizimin sistematik të letër-porosive</p> <p>7. Prezantimi i projekt-bazës ligjore për regjistrin qendror mbi pronësinë përfituese për personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore pranë Këshillit të Ministrave në përputhje me shkëmbimin e letrave midis Zëvendës Presidentit të Komisionit Dombrovskis</p>			<p>Shtator 2020</p> <p>Prezantimi i projektligjit: Qershor 2020</p> <p>Paketa Ligjore që do të miratohet: Tetor 2020</p>
--	--	---	--	--	--

Përparësi të rëndësishme

6	<p>Ulje e numrit të azilkërkuesve</p>	<p>Bashkëpunimi me Hollandën, Francën, BM, Gjermaninë, Italinë, Irlandën. Vazhdimi i Zbatimit të Planit Ndërinstitucional të Veprimit për parandalimin e azilkërkimit të qytetarëve shqiptarë në vendet e Schengen-it</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit për trendin e abuzimit me lëvizjen e lirë. 2. Forcimi i shkëmbimit të informacionit me qëllim identifikimin e shtetasve shqiptarë me qëndrim të parregullt në hapësirën Schengen. 3. Vazhdimi i operacioneve të kthimit të shtetasve shqiptar me qëndrim të parregullt në vendet anëtare të BE-së dhe në hapësirën Schengen. 4. Hartimi i një kuadri ligjor efektiv në lidhje me parandalimin e fenomenit të azilkërkimit abuziv, duke parashikuar masa shtrënguese për të udhëtuar drejt vendeve të hapësirës Shengen të personave të shpallur INAD apo DEPORTIV. 5. Intensifikimi i operacioneve, në bashkëpunim me FRONTEX--duke vendosur eskortë shqiptare në operacionet e kthimit të koordinuara nga FRONTEX-i. 6. Implementimi i strategjisë Kombëtare për Migracionin 	Qeveria	<p>Hartimi i kornizës ligjore në lidhje me masat e reja parandaluese :</p> <p>Qershor 2020</p> <p>Procesi në vazhdim</p>
---	--	---	---	---------	--

Commented [U8]: Prioriteti 6: Trajtimi i fenomenit të azilkërkuesve **dhe sigurimi i riatdhesimit të** shtetasve shqiptarë.

Tek **Masat** të trajtohet me përparësi trajtimi i shkaqeve që detyrojnë shtetasit shqiptarë të kërkojnë azil në vendet anëtare të BE, dhe ndihma ndaj komuniteteve më vulnerabël; Të trajtohen masat që lidhen me riatdhesimin e shtetasve shqiptarë, si dhe kosto financiare përkatëse; Të trajtohen masat që lidhen me riintegrimin e shtetasve të kthyer, sipas strategjisë dhe planit të veprimit përkatës, bashkë me kostot financiare.

7	Rishikimi i Ligjit të Medias në linjë me rekomandimet e Komisionit të Venecias	Masat, nëse do ketë nevojë, do të formulohen dhe miratohen bazuar ne opinionin e Komisionit të Venecias, në sesionin e planifikuar për tu zhvilluar në datat 16-20 Qershor 2020.	1. Komisioni i Venecias pritet të dërgojë një draft paraprak. 2. Deputetët dhe ministritë e përfshira do të punojnë për pasqyrimin e projekt-mendimit të Komisionit të Venecias, menjëherë sapo të dorëzohet.	Qeveria, Kuvendi	Nisja e pasqyrimin të Opinionit të Komisionit të Venecias: Qershor 2020 Rishikim i plotë: Tetor 2020
---	---	--	--	------------------	---

Commented [U9]: Prioriteti 7: Amendimin e ligjit të medias sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias

Masat: Të rishikohet nisma ligjore për median, në vijim të rekomandimeve të Komisionit të Venecias **dhe të Komisioneres për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës** (depozituese e kërkesës pranë Komisionit të Venecias).

Përparësi që pritet të reflektohen në Kornizën e Negocimit

8	Vazhdimi i Reformës në Drejtësi	Progres me proceset gjyqësore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për shkelje gjatë procesit të vetting	Identifikimi i rasteve dhe ndjekja për secilin rast	Institucionet e gjyqësorit	Në vazhdim
---	--	--	---	----------------------------	------------

Commented [U10]: Prioriteti 8: Nisjen e procedimeve penale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjetur me shkelje penale gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Masat: Të renditen rastet e identifikuar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, dhe ndjekja për secilin rast nga institucionet e gjyqësorit. Të përcaktohen qartë institucionet e ngarkuara me këtë proces dhe hapat që parashkohet të meren në këtë kontekst.

9	<p>Track Records- Inicimi dhe përfundimi i proceseve gjyqësore të shkallës së parë të zyrtarëve të lartë dhe politikanëve</p>	<p>1. Fillimi i punës i Rrjetit AntiKorrupsion të ngritur me urdhër të KM</p> <p>2. Rastet e Task Forces në Prokurori të shoqërohen me fillim të ndjekjes penale</p> <p>3. SPAK dhe Gjykata Speciale të kenë raste të suksesshme të hetimit dhe ndëshkimit të zyrtarëve të lartë.</p> <p>4. Koordinim ndër-nstitucional dhe implementimi i plotë i Rekomandimeve të Raundit të Katërt të GRECOs. Mbrojtja e suksesshme në Seancën Plenare.</p> <p>5. Përgatitja dhe koordinim nder-institucional per kthimin e përgjigjeve ndaj Greco për Seancen e 1rë Plenare të Roundit të 5të të GRECO për zyrtarët e lartë.</p>	<p>1. Lidhur me Rrjetin Anti Korrupsion:</p> <p>1.1 Duhet të emërohen anëtarët e Rrjetit Antikorrupsion në institucionet që ofrojnë shërbime për qytetarët dhe bizneset.</p> <p>1.2 Të fillojë hartimi i termave të referencës për nje sistem elektronik të çështjeve antikorrupsion.</p> <p>1.3 Rrjeti të zhvillojë rregullore dhe manuale për koordinimin me Drejtorinë Antikorupsion me qëllim hetimin e rasteve.</p> <p>1.4 Rrjeti të bashkëpunojë me Task Forcën për hetimin me sukses të rasteve të korrupsionit në administratën publike.</p> <p>2. Lidhur me rastet e Task Forces:</p> <p>2.1 Duhet qe cdo institucion i adm publike të zbatojë masat e rekomanduara nga TF. Zbatueshmëria vazhdon në shkallë të ulët.</p> <p>2.2 Ceshtjet penale të referuar nga TF në prokurori nuk fillohen ose pushohen. Më shumë bashkëpunim me prokurorinë dhe rritje e çështjeve të TF që shkojnë për ndjekje penale.</p> <p>3. Lidhur me ndëshkimin e politikanëve dhe zyrtarëve të lartë është masë që varet nga SPAK dhe gjykata Speciale.</p> <p>4. Vijimi i punës së Ministrisë së Drejtësisë në koordinimin e punës me Kuvendin, KLGJ, KLP, ILD për përmbushjen e 10 Rekomandimeve të GRECO 4. Vijimi i punës me Kryeministrinë dhe Ministrinë e Linjës për pyetësorin lidhur me korrupsionin tek zyrtarët e lartë.</p>	<p>Institucionet e gjyqësorit; Qeveria</p>	<p>Tashmë është krijuar Rrjeti Kundër Korrupsionit</p> <p>Pjesa tjetër e hapave: Në vazhdim</p>	<p>Commented [U11]: MUNGON prioriteti 9 (sipas konkluzioneve të 25 marsit 2020): Nisja e procedimeve penale kundër personave të akuzuar për blerjen e votes.</p> <p>Ndjekja e dosjeve penale që lidhen me krimin zgjedhor, nga institucionet e gjyqësorit. Të përcaktohen institucionet që ndjekin këto procese, dhe specifikohet gjurmimi i ecurisë së tyre.</p> <p>Commented [U12]: Prioriteti 9: Të ketë një gjurmim solid të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në të gjitha nivelet, përfshirë nisjen dhe përfundimin e procedimeve të para kundër zyrtarëve të lartë dhe politikanëve; Masat e parashikuara duhet të përfshijnë të dhënat konkrete që gjurmojnë ecurinë e proceseve gjyqësore në zinxhirin Polici-Prokurori-Gjykatë.</p>
---	--	--	--	--	---	---

10	Progres në reformën e administratës publike	<p>1. Përmirësim i mëtejshëm i procesit të rekrutimit dhe të zbatimit të vendimeve gjyqësore</p> <p>2. Ndërtimi i kapaciteteve dhe zbatimi i vlerësimeve të impaktit rregullator dhe buxhetor në të gjitha ministratë për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë financiare të propozimeve legjislative dhe politikave</p> <p>3. Ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme për të përafruar legjislacionin sektorial me Kodin e Procedurave Administrative (KPA)</p>	<p>1.1 Koordinimi periodik dhe raportimi me DoPA për zbatimin e masave. Krijimi i kushteve administrative-logjistike për zbatimin e vendimeve gjyqësore në administratën publike.</p> <p>2.1 Organizimi i trajnimit të vazhdueshëm me ministratë (7 seminare të planifikuara përmes Asistencës)</p> <p>2.2. Hartimi i 68 raporteve të RIA për projektligjet sipas planit analitik</p> <p>2.3. Përgatitja dhe miratimi i strategjisë "Rregullimi më i mirë";</p> <p>2.4 Kontrolli i cilësisë së raporteve në përputhje me kriteret e dakorduara me Delegacionin;</p> <p>2.5 Shqyrtimi dhe miratimi i kornizës metodologjike për vlerësimin e ndikimit rregullator;</p> <p>2.6. Përgatitja e analizave të ndikimit (me dhe pa vlerën monetare) në buxhetin e shtetit;</p>	Qeveria	Në vazhdim
11	Zbatimi i reformës zgjedhore	<p>1. Financimi transparent i partive</p> <p>2. Administrimi i paanshëm i procesit</p> <p>3. Procesi i rregullt</p>	Miratimi i Reformës Zgjedhore pas pasqyrit të opinionit të ODHIR. Raporti i ODHIR pas zgjedhjeve	Qeveria / Administrata Zgjedhore / Partitë Politike	Zgjedhjet e para të përgjithshme pas miratimit të reformës zgjedhore

12	Vendimi për ligjshmërinë e zgjedhjeve lokale 2019	Duhet plotësuar Gjykata Kushtetuese	Pasi Gjykata Kushtetuese të jetë në gjendje të miratojë vendime.	Gjykata Kushtetuese	Tremujori i 1 i 2021
13	Miratimi i Akteve nënligjore të Ligjit për Pakicat Kombëtare	<p>1. VKM e propozuar nga Ministria e Brendshme për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurave të Komisionit për të shqyrtuar kërkesat për njohje të minoriteteve</p> <p>2. VKM Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave përkatëse për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare, bazuar në të drejtën e vetë-identifikimit dhe të dokumentacionit në Regjistrin Civil.</p> <p>3. VKM-ja e MASR dhe MB mbi Kriteret për Përcaktimin e Njësisë së Pushtetit Lokal, numrin thelbësor dhe përcaktimin e kërkesave të mjaftueshme për garantimin e pakicave të drejtën për të studiuar gjuhën e tyre ose në gjuhën e tyre.</p> <p>4. VKM nga MB për përdorimin e gjuhëve të pakicave ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe njësisë së qeverisjes vendore</p> <p>5. VKM për Iniciativat dhe Projektet</p>	Vendimarrje nga Institucionet qendrore	Qeveria	VKM-të 1-4: Korrik 2020

		për të mbështetur Pakicat			
14	Miratimi i Ligjit (të amenduar) të Censurit	<p>1. Konsultime paralele për draftin me deputetët</p> <p>2. Konsultime me OJQ-të minoritare dhe ekspertë</p> <p>3. Komunikimi me EUD dhe Shtetet Anëtare</p> <p>4. Shqyrtimi i projektligjit në komisionet parlamentare, konsultimi me palët e interesuara dhe miratimi</p>	<p>1. Shqyrtimi i projektligjit nga Komisioni Parlamentar për Financë dhe Ekonomi</p> <p>2. Shqyrtimi i projektligjit nga Komisioni i Ligjit</p> <p>3. Konsultime me palët e interesuara</p>	Qeveria; Kuvendi	Tetor 2020

15	<p>Avancimi i procesit të regjistrimit të pronave</p>	<p>Progres me kuadrin nënligjor për Ligjin e Agjencisë së Kadastrës-hartimin e bazës nënligjore që e bën atë të zbatueshëm.</p>	<p>1. Shqyrtimi i projektligjit në Komisionin e Ligjeve</p> <p>2. Hartim i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 111/2018:</p> <p>i. Projektvendim "Për modelin e kartelës së pasurisë së paluajtshme" (hartuar 100%),</p> <p>ii. Projektvendim "Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme" (në hartim e sipër).</p> <p>iii. Projektvendim "Për modelin e certifikatës së pronësisë dhe të certifikatave për të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme" (hartuar 100%).</p> <p>iv. Projektvendim "Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës nga personat juridikë/fizikë vendas apo të huaj për të patur akses në sistemin elektronik" (hartim e sipër).</p> <p>v. Projektvendim "Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga SHKSH" (hartim e sipër).</p> <p>vi. Projektvendim "Për procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen" (hartuar 80%).</p> <p>vii. Projektvendim "Për rregullat e hollësishme mbi mënyrat dhe mjetet teknike-</p>	<p>Qeveria; Parlamenti</p>	<p>Legjislacioni plotësues i Ligjit Nr 111/2018, në lidhje me tarifën e shërbimeve kadastrale, si dhe modelin e certifikatës së pasurisë dhe certifikatave të tjera të pronësisë së pasurive të paluajtshme: Qershor 2020</p> <p>Sistemi në lidhje me shërbimet kadastrale në internet: Maj 2020</p>
----	--	---	---	----------------------------	--

hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrit të pasurive të paluajtshme" (hartim e sipër).

viii. Projektvendim "Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive të tjera natyrore"(draftim e sipër).

ix. Projektvendim "Për miratimin e listës së tarifave të shërbimeve kadastrale" (hartuar 100%, në proces miratimi).

x Projektvendim "Për elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi" (hartim e sipër).